

DEKRET
Nr.5759, datë 11.9.1978

**MBI DISA NDRYSHIME NË NDARJEN ADMINISTRATIVE TOKËSORE TË
REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 77 të kushtetutës;

**PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I.Në rrethin e Dibrës:

Fshati Lajthizë shkëputet nga fshati i bashkuar Fushë-Lurë të Dibrës dhe lidhet me fshatin e bashkuar me qendër në Klos të rrethit të Mirditës.

II. Në rrethin e Pogradecit

1.Krijohet fshati Gurëbardhë dhe lidhet me fshatin e bashkuar me qendër në Dunicë.

2.Krijohet fshati Buqezë dhe lidhet me fshatin e bashkuar me qendër në Udënishtë.

3.Krijohet fshati i bashkuar Dunicë me fshatrat Dunicë dhe Gurëbardhë.

III.Në rrethin e Skraparit:

Krijohet fshati Kovaçanj dhe lidhet me fshatin e bashkuar me qendër në Barç.

IV.Në rrethin e Tropojës:

Fshati Rushtë-Shëngjergj hiqet nga ndarja administrative.

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PËR PRESIDUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

SEKRETARI:

Telo Mezini

KRYETARI:

Haxhi Lleshi